



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Tetor 2024

Data 30.10.2024 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 27.09.2024 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shtator 2024.
- 3.Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj.Gjelina Çekaj në Qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuarit “Besa” Barbullush.
- 4.Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtarë 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës.
- 5.Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtarë 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës,sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë Shtetërore të Kadastres dhe Bashkisë Vau Dejës.
- 6.Projekt vendim për miratimin e disa vend parkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A Temal, Bashkia Vau Dejës.
- 7.Projekt vendim për rishqyrtim i Vkb Nr.69 datë 27.09.2024 “Dhënie pëlqimi në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet të sipërfaqes prej 1 ha, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt” fshati Stajkë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës”.Ndryshimi i përcaktimit të fushës së përdorimit të pronës.
- 8.Raport i monitorimit të Bashkisë Vau Dejës për periudhën Janar-Gusht 2024 si dhe vetëvlerësim i situatës e gjendjes financiare Janar-Gusht 2024.
- 9.Raport nga Drejtoria e menaxhimit të pyjeve ,inspektimit dhe mbrojtjes së mjedisit mbi zbatueshmërinë e VKB për periudhën Qershor 2023-Qershor 2024.
- 10.Raport nga Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritimit Sektori i Aseteve mbi zbatueshmërinë e VKB për periudhën Qershor 2023-Qershor 2024.
- 11.Të ndryshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Grupe interesi nuk kishte prezent në mbledhje. Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Tetor 2024, u zhvillua me datë 30.10.2024 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepja. Të pranishëm në sallë ishin 20 këshilltarë, (Gjovana Corri, Pjeter Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Florin Tanushi, Vijoleta Markolaj, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Frano Prenga, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Samed Hasmegaj, Sanije Salja) korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës. Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 20 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 27.09.2024 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 27.09.2024 nga Z.Ervis Shimaj. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarëve ju spjegua se vendimet e marra në mbledhjen e muajit Shtator, Vkb nr.69 dhe nr.70, ishin kthyer nga Institucioni i Prefektit Qarkut Shkoder për plotësim nga ana e administrates.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shtator 2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike, e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se , bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Shtator 2024, te perfitojne 140 familje, me 473.925 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Shtator 2024 janë shpallur fitues, 1.008 familje, me fond 7.914.421 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 474.865 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota Pro. zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjovana Corri, Pjeter Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Florin Tanushi, Vijoleta Markolaj, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Frano Prenga, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Ornella Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Samed Hasmeqaj, Sanije Salja.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim për pranimin e të moshuares Znj.Gjelina Çekaj në Qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuarit "Besa" Barbullush.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Aurela Deda- specialiste e sektorit të shërbimit social pranë Bashkise Vau Dejes, e cila spjegon përpara këshilltarëve se Znj.Gjelinë Çekaj ka paraqitur kërkesen pranë Sektorit të Shërbimit Social, Bashkia Vau Dejës, për sistemim në Qendrën e Përkujdesit Social për të Moshuar "Besa", Barbullush. Komisioni multidisiplinar i ngritur me urdherin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 13 date 09.03.2023 "Per ngritjen e Komisionit Multidisiplinare per vlersimin e rasteve te personave qe kane nevojë per sherbime te kujdesit shoqerore komunitare dhe rezidenciale publik dhe jopublik" ka bërë vlersimin e dokumentacionit dhe ka rezultuar se e moshuara Znj.Gjelinë Çekaj i plotëson kriteret për tu pranuar pranë Qendrës së Përkujdesit Social për të Moshuar "Besa", Barbullush.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota Pro, zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e tretë të rendit të ditës:

Gjovana Corri, Pjeter Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Florin Tanushi, Vijoleta Markolaj, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Frano Prenga, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Ornella Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Samed Hasmeqaj, Sanije Salja.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 "Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtarë 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj citon se për këtë projekt vendim është realizuar dëgjese publike me datë 24.10.2024 dhe se të pranishmit kishin shprehur dakortesi për projekt vendimin.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin, Znj.Elsa Tanushi – Drejtore e zyrës Financë Buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejës, e cila relaton për projekt vendimin se është parë e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

nevojshme që të bëhet ndryshim i numrit të punonjësve mbështetës në sektorin e MZZH-së rritje prej 5 punonjësish, në sektorin e arsimit, rritje 5 punonjës roje shkollë dhe 5 punonjës, sanitare në shkolla.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Pjeter Lleshi- sugjeron se shtimi i numrit të punonjësve duhet të bëhet në raport me shërbimet që ato kryejnë, sepse kam vërejtur se në Njesinë Administrative Vig Mnelë, këtë vit kanë rënë zjarre dhe zjarrfikësit nuk i kanë kushtuar vëmendje për ti shuar këto zjarre, pamvarësisht se shtëpijat kanë qenë të vjetra dhe pa banorë. Megjithëse këto shtëpia kanë qenë të tilla, MZZH-ja pranë Bashkisë është dashur të ndërhyjë sepse ato janë prona që me kalimin e kohës pronarët e tyre mund të investojnë në shtëpijat e tyre. Gjithashtu kam kërkesë që rrugët në këtë njësi të mirëmbahen nga Bashkija. Pra të përdoret llogjika ekonomike në procesin e rritjes së numrit të punonjësve, nëse shtohet numri i punonjësve të bëhet edhe puna. Këtë pikë të rendit të ditës do e votoj kundra.

Z.Kristian Shkreli-Kryetar i Bashkisë: Është e qartë se në gjithë territorin e Bashkisë, ka nevojë që puna të përmirësohet por duhet të kemi parasysh se problematikat që kanë qenë para disa viteve, tani nuk janë më, sepse është punuar shumë nga ana jonë në të gjitha drejtimet. Normalisht që ka nevojë për përmirësim, por punën dhe vëmendjen e kemi në përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë banorët.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro, 1(një) votë kundër(Z.Pjetër Lleshi) dhe 1(një) votë abstenim (Znj. Vijoleta Markolaj).**

Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt të rendit të ditës:

Gjovana Corri, Rregjinë Shelqetja, Florin Tanushi, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Frano Prenga, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Samed Hasmeqaj, Sanije Salja.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtarë 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës, sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë Shtetërore të Kadastres dhe Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin, Znj.Elsa Tanushi – Drejtore e zyrës Financë Buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejës, e cila relaton për projekt vendimin se në funksion të Vkb nr.73/2024, si dhe bazuar në vendimin nr.322 datë 31.05.2023 “ Për miratimin e struktures së pages dhe te niveleve te pagave te nepunesve dhe punonjesve administrativ në ASHK, në vendimin



nr.325 datë 31.05.2023, në vendimin nr.422 datë 26.06.2024, për një ndryshim në vendimin nr.326 datë 31.05.2023 të K.M, është caktuar niveli i pagë për një punonjës specialist(inxhinjer) dhe një punonjës teknik i mesëm,për një periudhë 12 mujore, të cilët do paguhen me fondet tona.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e pestë të rendit të ditës:

Gjovana Corri,Pjeter Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Florin Tanushi, Vijoleta Markolaj, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Frano Prenga, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Ornella Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Samed Hasmegaj, Sanije Salja.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e disa vend parkimeve publike në fshatin Koman, Nj.A Temal, Bashkia Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj citon se për këtë projekt vendim është realizuar dëgjese publike me datë 17.10.2024 dhe se të pranishmit kishin shprehur dakortesi për projekt vendimin.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin, Znj.Dorina Lekaj-juriste pranë drejtorisë planifikimit territorit,kadastres dhe investimeve publike pranë Bashkisë Vau Dejës e cila spjeron se bazuar në problematikat e shtruara nga Njësia Temal,lidhur me nevojen dhe damosdoshmerinë e ngritjes së disa vendparkimeve në këtë njësi për arsye të rritjes së fluksit të turistëve që vizitojnë këtë zonë është hartuar ky projekt vendim, i cili është i bazuar në ligj.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e gjashtë të rendit të ditës:

Gjovana Corri,Pjeter Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Florin Tanushi, Vijoleta Markolaj, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Frano Prenga,



Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Samed Hasmeqaj, Sanije Salja.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:

Projekt vendim për rishqyrtim i Vkb Nr.69 datë 27.09.2024 “Dhënie pëlqimi në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet të sipërfaqes prej 1 ha, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt” fshati Stajkë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës”.Ndryshimi i përcaktimit të fushës së përdorimit të pronës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin, Z.Ndoc Baqli-përgjegjës i zyres asetëve pranë Bashkisë Vau Dejës i cili spjeron për këshilltarët se është shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjen e radhës së muajit Shtator ky projekt vendim por institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër ka referuar se vendimi ka mospërputhje me kategorizimin e tokës “Pa fryt” dhe nuk ka lidhje me ushtrim aktivitet bujqësor.Për këtë qëllim kemi paraqitur projekt vendimin për shqyrtim të Vkb nr. 69 datë 27.09.2024, duke saktësuar fushen e përdorimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e shtatë të rendit të ditës:

Gjovana Corri,Pjeter Lleshi, Rregjinë Shelqetja, Florin Tanushi, Vijoleta Markolaj, Mark Bisha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Frano Prenga, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Vjollcë Zagani, Ornela Lleshi, Besmir Kapaj, Meliha Zyberaj, Samed Hasmeqaj, Sanije Salja.

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:

Raport i monitorimit të Bashkisë Vau Dejës për periudhen Janar-Gusht 2024 si dhe vetëvlerësim i situatës e gjendjes financiare Janar-Gusht 2024.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin, Znj.Elsa Tanushi – Drejtore e zyres Financë Buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejës, e cila në mënyrë esenciale spjeron se për periudhen 8 mujore të këtij viti kemi rritje të të ardhurave rreth 30 % dhe për rrjedhojë edhe buxheti ka pesuar rritje ne zbatueshmerine e tij.Gjatë 8 mujorit kemi arketuar 60% e te ardhurave te detyrueshme per tu paguar brenda ketij viti te cilat jane te detajuara edhe shpenzimet sipas kategorive.Është rritur



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

arketimi i detyrimeve të prapambetura dhe për rrjedhojë gjendja ekonomiko-financiare e bashkisë është e mirë.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime lidhur me raportin dhe shprehën dakortësi.

Z. Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:

Raport nga Drejtoria e menaxhimit të pyjeve, inspektimit dhe mbrojtjes së mjedisit mbi zbatueshmërinë e VKB për periudhën Qershor 2023-Qershor 2024.

Z. Ervis Shimaj spjegon se sipas kërkesës së disa këshilltarëve në mbledhjen e muajit Shtator dhe detyrimit ligjorë që ka administrata për të raportuar para këshillit, kemi sjellë në raport për zbatueshmërinë e vendimeve për periudhën Qershor 2023-Qershor 2024 përfaqësues nga Drejtoria e menaxhimit të pyjeve, inspektimit dhe mbrojtjes së mjedisit, material i cili është sjellur me shkrim nga ana e tyre dhe jeni të pajisur të gjithë me këtë informacion.

Z. Ervis Shimaj fton për të raportuar Z. Mark Suli-inxhinjer i zyres pyjeve i cili raporton për zbatueshmërinë e vendimeve të marra nga Këshilli Bashkiak për periudhën Qershor 2023-Qershor 2024, zbatimin e procedurës së konkurrimit publik, lidhjen e kontaktave dhe pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë.

Z. Ervis Shimaj lexon piken e dhjetë të rendit të ditës:

Raport nga Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritetit Sektorial i Aseteve mbi zbatueshmërinë e VKB për periudhën Qershor 2023-Qershor 2024.

Z. Ervis Shimaj spjegon se sipas kërkesës së disa këshilltarëve në mbledhjen e muajit Shtator dhe detyrimit ligjorë që ka administrata për të raportuar para këshillit, kemi sjellë në raport për zbatueshmërinë e vendimeve për periudhën Qershor 2023-Qershor 2024 përfaqësues nga Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritetit Sektorial i Aseteve material i cili është sjellur me shkrim nga ana e tyre dhe jeni të pajisur të gjithë me këtë informacion.

Z. Ervis Shimaj fton për të raportuar Z. Ndoc Baqli-specialist i zyres asetëve i cili raporton për zbatueshmërinë e vendimeve të marra nga Këshilli Bashkiak për periudhën Qershor 2023-Qershor 2024, zbatimin e procedurës së konkurrimit publik, lidhjen e kontaktave dhe pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë.

Pika 11 Të ndryshme:

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për ndonjë pyetje apo diskutim. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera, Kryetari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës e deklaroi të mbyllur mbledhjen e datës 30.10.2024.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

- Ervis Shimaj
- Samir Hasani
- Mirza Zekaj
- Boris Kallaj
- Imzhet Kallaj
- Ervis Kallaj
- Mirza Kallaj
- Gjergj Gani
- Piter Praci
- Onela Llajhi
- Mirza Rizaj
- Piter Hasani
- Mirza Zogaj
- Boris Kallaj
- Iconer Drita
- Samir Selaj